

Në bazë të nenit 20 alinea 9 dhe neni 6 të Rregullores për organizimin e zgjedhjeve për Kryetar të Parlamentit Studentor në Universitetin e Tetovës dhe në njësitë e Universitetit të Tetovës, Parlamenti Studentor i Universitetit të Tetovës, në mbledhjen e mbajtur më 12.12. 2016, sollli këtë:

VENDIM

për formimin e Komisionit Zgjedhor të Parlamentit Studentor në Universitetin e Tetovës

Neni 1

Formohet Komisioni Zgjedhor i Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës për organizimin e zgjedhjeve për zgjedhjen e Kryetarit të Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës, Kryetarit të Parlamentit Studentor të fakultetit dhe anëtarëve të Parlamentit Studentor të fakulteteve në Universitetin e Tetovës, i formuar prej 7 anëtarësh, nga fusha të ndryshme shkencore, në përbërje:

1. EMIR AKIFI – Fakulteti EKONOMIK, Kryetar
2. HADMIR JMERI – Fakulteti MJEKËSI, anëtar
3. FATJONA ALIU – Fakulteti P.K.F, anëtar
4. YILZA AMETI – Fakulteti FILOZOFIK, anëtar
5. DENIS MIFTARI – Fakulteti JURIDIK, anëtar
6. AGRONI FABLIV – Fakulteti F.SH.M. I., anëtar
7. VALMIR SALII – Fakulteti EKONOMIK, anëtar

Neni 2

Mandati i anëtarëve të Komisionit Zgjedhor të Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës zgjat 2 (dy) vite.

Neni 3

Komisioni zgjedhor i Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës obligohet që t'i organizojë (realizojë) zgjedhjet studentore në pajtim me Vendimin për shpalljen e zgjedhjeve për zgjedhjen e Kryetarit të Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës, Kryetarit të Parlamentit Studentor të fakultetit dhe anëtarëve të Parlamentit Studentor të fakulteteve në

Universitetin e Tetovës, në pajtim me Rregulloren për organizimin e zgjedhjeve për Kryetar të Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës dhe njërive të Universitetit të Tetovës dhe Statutin e Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes së tij dhe i njëjti do të shpallet në tabelat e shpalljeve të fakulteteve dhe Rektoratit të Universitetit.

Tetovë, më 12.12.2016



Kryetari i
Parlamentit Studentor-UT
Ardian Bilalli